PSH.nr. 844/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas parashtresës/ kërkesës se OE "Samire Osmani B.I , lidhur me mos zbatim te vendimit te OSHP 844/20 te datës 20.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "SPERKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE Nr. i AP: 62500-20-927-2-2-1_62500-20-021-221 , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Malishevës , më datën: 09.12.2020 mori këtë:

U R DH Ë R E S Ë

I.APROVOHET, si e bazuar parashtresës/ kërkesës se OE "Samire Osmani B.I , lidhur me mos zbatim te vendimit te OSHP 844/20 te datës 20.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "SPERKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE Nr. i AP: 62500-20-927-2-2-1_62500-20-021-221 , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Malishevës.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Malishevës , që të zbatojë vendimin e OSHP-së me numër: PSH nr. 844/20, i protokolluar me datë: 20.11.2020 , përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: "SPERKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE Nr. i AP: 62500-20-927-2-2-1_62500-20-021-221 , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Malishevës.

III. URDHËROHET, Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna Malisheves që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në, dhe operatorin ekonomik OE "Samire Osmani B.I , lidhur me zbatimin, e vendimit të OSHP-së, PSH 844/20 te datës 13.11.2020, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: "SPERKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE Nr. i AP:

62500-20-927-2-2-1_62500-20-021-221 , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Malishevës.

IV. Mos respektimi i kësaj urdhërese, brenda periudhës prej pesë ditë kalendarike, do ta detyroj panelin shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe njëkohësisht të kërkoj nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK Komuna e Malishevës /sipas nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues OE "Samire Osmani B.I , me date 02.12.2020, me ane te parashtresës në mënyrë elektronike e ka njoftuar OSHP –ne se AK KK Malishevë nuk po e respekton vendimin e OSHP-se PSH nr. 844/20 te datës 13.11.2020, duke theksuar si me poshtë:
Shpresoj se jeni mire dhe po kaloni mire. Kërkojë ndjese për pengese por sipas vendimit te Organit te Shqyrtimit te Prokurimit me numër vendimi 844-20 Autoriteti Kontraktues ,Komuna e Malishevës Obligohet qe te zbatoje vendimin e OSHP-se nr 530-20 dhe po ashtu sipas vendimit 844-20 te vazhdoje me nënshkrimin e kontratës mirëpo Autoriteti Kontraktues KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE nuk i përfill fare urdhëresat qe dalin nga Organi me i larte i Prokurimit Publike .Andaj konform ligjeve ne fuqi kërkojë qe për aktivitetin me titull SPERKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET HEMORRAGJIKE Nr. i AP: 62500-20-927-2-2-1_62500-20-021-221 te mirren masa ndëshkimore ndaj Autoritet Kontraktues .Mbetem me shprese se kërkesa ime te shqyrtohet sa me pare nga ana juaj .

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues sqaron se me vendimin PSH nr. 844/20, i protokolluar me datë: 13.11.2020, OSHP- ja, ka vendosur që të "aprovohet si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Samire Osmani B.I lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: SPERKATJA NGA TOKA E ZONAVE ENDEMIKE NGA ETHET

HEMORRAGJIKE Nr. i AP: 62500-20-927-2-2-1_62500-20-021-221 , të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Malishevës dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë të kthehet në Rivlerësim .

Paneli shqyrtues konstaton e autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar vendimin e cekur si me lart PSH nr. 844/20, i protokolluar me datë: 20.11.20 , andaj ju bëjmë me dije se vendimet e OSHP-së, janë të obligueshme për tu zbatuar nga ana e autoriteteve kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët kanë të drejt ti drejtohen gjykatës kompetente brenda afatit ligjor me anë të mjeteve të rregullta juridike, konform këshillës juridike të dhënë në vendim.

Prandaj, Paneli shqyrtues, kërkon nga AK-Komuna e Malishevës të zbatohet në tërësi vendimi i PSH-së nr. 844/20, i protokolluar me datë: 13.11.20 dhe po ashtu të respektohen dispozitat e nenit 26 të LPP-së. OSHP-ja e urdhëron AK- Komuna e Malishevës që të merr masa për zbatimin e vendimit të lartpërmendur brenda pesë (5) ditëve sepse mos respektimi i kësaj urdhërese, brenda periudhës prej pesë ditë kalendarike, do ta detyroj panelin shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së dhe njëkohësisht të kërkoj nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të AK Komuna e Malisheves /sipas nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 dhe 105 paragrafi 2.10 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të kësaj urdhërese

Urdhëresa t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Malishevës

1x1OE Samire Osmani B.I ,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA